




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



SHËRBIMI I PROVËS



Nr. 227 , datë 01 / 02/2024

Nr. 146 , datë 01 / 02/2024

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT TË PROVËS

dhe

FAKULTETIT TË DREJTËSISË, UNIVERSITETI I TIRANËS

Sot me datë, 01 . 02 .2024, lidhet kjo Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Palëve:

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, me adresë: Rruga “Jordan Misja”, Ndërtesa 6/1, Hyrja 1, Kodi Postar 1016, Tiranë, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës Z. Klevis Qose, këtu e në vijim “DPSHP”,

dhe

Fakulteti Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, me adresë: Rruga “Mילו Tutulani”, Tiranë, përfaqësuar nga Dekani i Fakultetit Znj. Dorina Hoxha, këtu e në vijim “Fakulteti”,

Palët në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi bien dakort për nënshkrimin e saj si më poshtë:

Neni 1 Objekti i Marrëveshjes

Objekti i kësaj Marrëveshjeje konsiston në ofrimin e mundësive të lehtësuara për punonjësit e Shërbimit të Provës në studimet master në shkencat juridike (e drejtë penale, e drejtë civile, e drejtë publike, etj), ofrimin e lehtësive ndaj studentëve dhe stafit akademik të Fakultetit të Drejtësisë, të cilët zhvillojnë punime shkencore dhe kërkimore në nivel masteri dhe doktorature e kualifikime në vazhdim, ofrimin e trajnimeve afatshkurtra, konferencave, seminareve apo leksioneve të hapura, të përbashkëta, përdorimin reciprok të ambienteve të institucioneve dhe shkëmbimin e materialeve të studimeve apo projekteve të realizuara.

Neni 2 Baza ligjore

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi bazohet në ligjin 37/2017, datë 30.03.2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur” në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, në ligjin 79/2020 “Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale”, në ligjin nr. 78/2020 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Shërbimit të Provës”, në VKM nr. 421 datë 08.07.2021 “Për miratimin e rregullores së përgjithshme të Shërbimit të Provës”, si dhe në ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 3 Qëllimi i Marrëveshjes

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës dhe Fakulteti i Drejtësisë lidhin këtë Marrëveshje me qëllim bashkëpunimin në drejtim të mbështetjes reciproke, shkëmbimit të përvojave dhe krijimit të mundësive për trajnime, kualifikime, zhvillimit të praktikave dhe kryerjes së studimeve të përbashkëta në fushën e të drejtës penale, drejtësisë restauruese dhe masave alternative të dënimeve me burgim.

Neni 4 Detyrimet e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës

1. DPSHP vë në dispozicion të kërkuesve shkencorë gjithë informacionin e kërkuar, me qëllim realizimin e punimeve kërkimore e shkencore në përputhje dhe në respektim të kuadrit ligjor

në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe siguron kushtet e nevojshme brenda mundësive që disponon për të garantuar mbarëvajtjen dhe ecurinë gjatë punës kërkimore.

2. DPShP garanton krijimin e lehtësive për kryerjen e praktikave profesionale të studentëve pranë ambienteve të Degëve Territoriale të Shërbimit të Provës në varësi të mundësive dhe potencialit të disponueshëm.

3. DPShP garanton realizimin e aktiviteteve promovuese të punimeve kërkimore e shkencore që do të realizohen sipas kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi.

4. DPShP garanton se nuk do të bëjë publike rezultate apo arritje të punimeve kërkimore pa marrë më parë pëlqimin me shkrim të Fakultetit dhe autorit të veprës.

5. DPShP dhe Degët Territoriale të saj do të marrin pjesë në veprimtaritë, trajnimet dhe aktivitetet e ndryshme ligjore, sociale dhe edukative që do të zhvillojë Fakulteti, që kanë lidhje me çështjet e dënimeve alternative apo me të miturit në konflikt me ligjin.

Neni 5 Detyrimet e Fakultetit

1. Fakulteti do të përfshijë në kurrikulat e veta në vijim, Shërbimin e Provës si dhe çështjet që kanë të bëjnë me të duke promovuar përpara studentëve, kërkuesve dhe stafit akademik që kryen punime kërkimore e shkencore, tematika që kanë të bëjnë me Shërbimin e Provës.
2. Fakulteti në bashkëpunim me Shërbimin e Provës koordinon zhvillimin e praktikave mësimore, punimeve kërkimore e shkencore, si dhe çdo veprimtarie që lidhet me shkëmbimin e eksperiencave të përbashkëta dhe promovimin e tyre në komunitet.
3. Fakulteti realizon veprimtaritë e sipërpërmendura në varësi të burimeve dhe potencialit që disponon.
4. Fakulteti vë në dispozicion ambientet dhe infrastrukturën e nevojshme për realizimin e trajnimeve, fushatave informuese e sensibilizuese, leksioneve të hapura, të organizuara nga DPShP dhe degët territoriale të saj.
5. Fakulteti kontribuon me publikimet informuese dhe ndërgjegjësuese për rritjen e nivelit edukativ, social e ligjor të studentëve në kuadrin e dënimeve alternative për t'i ndihmuar në njohjen më të gjerë të institucionit të Shërbimit të Provës.

Neni 6 Kohëzgjatja

Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar nga dita e nënshkrimit dhe do të jetë efektive përgjatë kësaj periudhe.

Neni 7 Personat e kontaktit

1. Secila nga palët përcakton një person kontakti të cilës/it i drejtohen të gjitha komunikimet, qofshin verbale apo të shkruara, si elektronike ashtu dhe të shtypura në letër. Në çastin e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje personat e kontaktit janë si në Aneksin 1.

2. Personat e caktuar në Aneksin 1, bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje, do të jenë përgjegjës për

saktësinë e protokolleve, proces - verbaleve, listave dhe çdo dokumenti shoqërues që do të dalë në zbatim të Marrëveshjes.

3. Në rast të ndryshimit të njërit nga personat e caktuar në Aneksin 1, pala e cila përfaqësohet prej këtij personi, do të njoftojë me shkrim palën tjetër nënshkruese të dhënat e personit të ri të kontaktit brenda 1 (një) jave kalendarike nga data e ndryshimit, të cilat njëkohësisht do t'i bashkëlidhen Marrëveshjes nëpërmjet ankeseve.

Neni 8 Zbatimi i Marrëveshjes

1. Palët marrin përsipër zbatimin e kësaj Marrëveshjeje nga data e nënshkrimit të saj.
2. Për çdo problem gjatë zbatimit të Marrëveshjes, palët marrin përsipër të komunikojnë midis tyre për zgjidhjen me mirëkuptim të të gjitha mosmarrëveshjeve që mund të rrjedhin gjatë zbatimit të saj.
3. Çdo ndryshim i akteve ligjore e nënligjore, për aq sa ato lidhen me këtë Marrëveshje, do të reflektohet zyrtarisht në ndryshimin e saj.

Neni 9 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve zgjidhen me frymën e mirëkuptimit dhe me bisedime ndërmjet tyre.

Neni 10 Dispozita të fundit

1. Palët janë të detyruara të respektojnë këtë Marrëveshje për të gjithë kohëzgjatjen e parashikuar në Nenin 6 të saj.
2. Çdo palë merr përsipër të përmbushë detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje pa pretendim financiar ndaj palës tjetër.
3. Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një dokumenti me shkrim të nënshkruar nga të dyja palët.
4. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët dhe hartohet në 4 (katër) kopje të barazvlefshme në gjuhën shqipe, nga 2 (dy) kopje për secilën palë.

PËR

**DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË
SHËRBIMIT TË PROVËS**

DREJTORI I PËRGJITHSHËM



Klervis Qose

PËR

**FAKULTETIN E DREJTËSISË
UNIVERSITETI I TIRANËS**

DEKANI

Prof. Asoc. Dr. Dorina Hoxha



Aneksi 1: Personat e Kontaktit

Për DPSHP:

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës: Drejtoria e Inspektimit dhe Shërbimeve Komunitare

Emër Mbiemër: Anesti Kapllani

Pozicioni: Drejtor

Adresa: Rruga Jordan Misja, Ndërtesa 6/1, Hyrja 1, Kodi postar 1016

Numri i Telefonit: :+355 69 287 0100 +355 68 275 7764

E-Mail: anesti.kapllani@sherbimiproves.gov.al

Data: 01.02.2024

Për Fakultetin:

Fakulteti: Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës

Emër Mbiemër: Prof.Asoc.Dr Jonad Bara

Pozicioni: Zv. Dekan

Adresa: Rruga Milto Tutulani

Numri i Telefonit: +355 68 608 0333

E-Mail: jonad.bara@fdut.edu.al

Data: 01.02.2024